



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:231951
Datë: 10.01.2024
Numri i dokumentit: 05173707

AA.nr.973/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Valon Totaj, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesional Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit - propozuesit av. E... K... me seli të zyrës në Prishtinë, kundër të paditurës/kundërpropozueses, Oda e Avokatëve të Kosovës, me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1891/2023, të datës 02.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Oda e Avokatëve të Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1891/2023, i datës 02.11.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative A.nr.1891/2023, të datës 02.11.2023, në pikën I të dispozitivit të aktvendimit është aprovuar si i bazuar propozimi i paditësit/propozuesit, E... K..... Në pikën II të dispozitivit është shtyrë ekzekutimi i Vendimit të të paditurës, Odes së Avokate të Kosovës-Komisioni i Ankesave V.K.A.nr.25-3-2/23 te dt.22.09.2023 me të cilin vendim ka mbetur ne fuqi vendimi i Komisionit Disiplinor V.K.D.Nr.25-3-1/2023 i dt.11.07.2023, derisa gjykata të vendosë me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Oda e Avokatëve të Kosovës, me seli në Prishtinë, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet në tersi si e bazuar ankesa e të paditurës, ta prishë ose ta ndryshoj aktvendimin e goditur duke ia njohur të drejtën legjitime.

Përgjigje në ankesa në afat ligjor ka paraqitur paditësi-propozuesi E... K... me seli të zyrës në Prishtinë, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta hedh ankesën si të palejuar meqë është ushtruar nga personi që nuk ka mandat ligjor në OAK.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, përgjigjen në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së të paditurës, kolegji i kësaj gjykate gjen se gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të propozimit të paditësit-propozuesit për caktimin e masës së përkohshme për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të paditurës, ka gjetur se propozimi i tillë është i bazuar, për faktin se kjo gjykatë për te vlerësuar propozimin ju referua nenit 22 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: *“Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t’i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”*. Ndërsa me paragrafin 6 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“Paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”*. Bazuar në dispozitat e lart cekura gjykata e shkallës së parë duke shqyrtuar kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues ka vlerësuar se propozuesi ka ofruar argumente të besueshme se me masën e shqiptuar disiplinore me humbje të drejtës se ushtrimit te avokatisë për gjashtë (6) muaj me këtë masë të shqiptuar do të pësojnë me shumë palët e interesit të përfaqësuar nga propozuesi ashtu që me këtë rast të njëjtëve do tu shkaktohet dem i cili dëm vështirë do të riparohej. Prandaj gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar deri në vendosjen e çështjes në mënyrë meritore, nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare. Këtë vlerësim gjykata e shkallës së parë e mbështeti në faktin se propozuesi ka argumentuar mjaftueshëm se bazuar në dispozitat e lart cekura janë përmbush kushtet ligjore që të aprovohet propozimi i tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, deri sa gjykata të vendosë përfundimisht lidhur me ligjshmërinë i vendimit të kontestuar përkitazi me padinë në vështrim të nenit 22 pika 5 dhe 6 të LKA-së. Ky aktvendim nuk prejudikon vendosjen në mënyrë meritore sipas padisë.

Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë vendim duke bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, shkeljeve për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata e shkallës së parë nuk e ka analizuar mirë gjendjen faktike kur ka vendosur lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të paditurës pa marrë parasysh farë faktin që paditësi në rastin konkret ka kryer shkelje të rëndë disiplinore nga neni 118 par.1 nën par. 1.12 të Statutit të OAK-së lidhur me nenin 14 pika b të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit dhe nenit 39 të Ligjit të Avokatisë, shkelje kjo që e dëmton rëndë imazhin e avokatisë dhe nëse ky vendim si i tillë nuk zbatohet do të prodhonte efekte negative për anëtarësinë dhe njëherit do ti stimulonte të njëjtit për kryerjen e shkeljeve të tilla, pra do të shërbente si provë e cila i motivon anëtarët e saj që të kryejnë shkelje të ndryshme të Kodit të Etikës Disiplinore dhe njëherit edhe vendimet e gjykatës do ti pranonin si të buta dhe jo serioze. Vlen të potencohet fakti se paditësi e ka pranuar përgjegjësinë disiplinore dhe ka nënshkruar marrëveshje për pranimin e përgjegjësisë disiplinore, gjithashtu pretendimet e tij për shkaktimin e dëmit të pariparueshëm, i njëjti ka mundur që lëndët e tij t’ia transferoj për periudhën 6 mujore ndonjë kolegu për të cilin kishte për ta vlerësuar se mund të përfaqësoj denjësisht.

Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të paditurës në ankesë, të cekura më lartë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se të njëjtat nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e aktvendimit të goditur, meqë të njëjtat janë të pa argumentuara me prova konkrete dhe jo bindëse për tu aprovuar. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit është se janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Ngase, edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, paditësi – propozuesi ka dhënë arsytim të mjaftueshëm. Pra, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar si të bazuar propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, ngase kjo shmang pasojat e mundshme që do të shkakttoheshin në të ardhmen nëse vendimi i kontestuar i të paditurës në fund të procesit gjyqësor rezulton se është marrë në kundërshtim me ligjin. Prandaj, edhe kolegji i Gjykatës së Apelit pa paragjykim ndaj vendimit të mëtejshëm që do të nxirret nga gjykata e shkallës së parë për kërkesëpadinë e paditësit, vlerëson se kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar është dashtë të aprovohet si e bazuar.

Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve kolegji i kësaj gjykate gjen se Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesës së paditësit - propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës me rastin e aprovimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast paditësi - propozuesi në ankesën e ushtruar ka dhënë arsytim të besueshëm me prova konkrete se janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, e me të cilat është arsyetuar shtyrja e ekzekutimit, duke i'u referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par.2 të LKA-së. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe se në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tille refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.973/2023, me datë 27.12.2023

Kryetari i Kolegji
Ramiz Kuqi